



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 1345 Prot

Vlorë, më 03 . 7 . 2019

VENDIM

Nr. 14 , datë 25 . 06 . 2019

PËR VENDOSJEN E ESHTRAVE TË “DËSHMORIT TË ATDHEUT” ISMAIL RUSHIT SHAKOHOXHAJ, NË VARREZAT E DËSHMORËVE TË ATDHEUT TË QYTETIT TË VLORËS

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.06.2019 në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.109/2018, datë 20.12.2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.151, datë 25.04.2002 “Për Statusin Dëshmor i Atdheut” i ndryshuar, kërkesës së familjarëve të “Dëshmorit të Atdheut”, protokolluar me tonën Nr. 965 Prot, datë 13.05.2019 si dhe korrespondencës me bashkinë Vlorë ;

VENDOSI;

1. Të bëhet vendosja e eshtrave të “Dëshmorit të Atdheut” Ismail Rushit SHAKOHOXHAJ (1883 - 1944), i shpallur i tillë me Vendimin Nr.56, datë 17.06.2005 të Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, në varrezat e “Dëshmorëve të Atdheut” të qytetit të Vlorës.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me Nr. _____ Prot, datë ____ . ____ . 2019.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “ 4 Heronjtë ”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600